



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Autoriteti Kosovar i Konkurrencës
Autoritet Kosova za Konkurenciju - Kosovo Competition Authority

Prishtinë, 17 Tetor 2022
Vendimi, Nr. 37/22

Duke u bazuar në nenet 11,13,15,16,17,18,26,27 dhe 55 të Ligjit 08/L-056 Për Mbrojtjen e Konkurrencës, nenet 18 dhe 20 të Udhëzimit Administrativ Nr.06/2012 Për Mënyrën e Paraqitjes së Kërkesës dhe Kriteret për Konstatimin e Përqendrimit të Ndërmarrjeve si dhe Udhëzimin Administrativ Nr.02/2018 Për Mënyrën e Përcaktimit të Tregut Relevant, Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës, në mbledhjen e datës 17.10.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. LEJOHET Përqendrimi i ndërmarrjeve Alfi, Management of Alternative Investment Funds, Ltd (blerës) për blerje të 100% të aksioneve nga z.Bahtijar Bajrović së bashku me ndërmarrjen Sibelius Sonic Limited (shitësit).

Alfi, Management of Alternative Investment Funds, Ltd me numër të regjistrimit 7239327000, i regjistruar në Republikën e Sllovenisë me adresë në rr. Verovškova 55A, 1000, Lubjana, Republika e Sllovenisë, drejtues i fondit Alfi D.o.o. PE Alfli II Specialni Investicijski sklad, me numër të regjistrimit 7239327002, i regjistruar në Republikën e Sllovenisë, me adresë në Rr. Verovškova 55A,1000, Lubjanë, Republika e Sllovenisë ("Alfi II").

Z.Bahtijar Bajrović me vendbanim në Rr. Kajuhova 36, 4260 Bled, Republika e Sllovenisë dhe ndërmarrja Sibelius Sonic Limited, Prodromou 75, Oneworld Parkview House, 2063 Nikosia, Qipro, numri i regjistrimit HE232714 ("Sibelius Sonic Limited"), të dy shitësit janë aksionarë në kompaninë Sportina, zunanja in notranja trgovina na debelo in drobnno, proizvodnja, zastopanje, posredovanje in organizacija, Bled, d.o.o., me adresë të regjistruar në Alpska 43, 4248, Lesce ("Sportina" apo "Kompania e Synuar").

Targeti: Sportina d.o.o., me adresë të regjistruar në rr. Alpska 43, 4248 Lesce, me numër të regjistrimit 5331765000; Bajcon d.o.o. me adresë në Rr. Alpska 43, 4248 Lesce, Slloveni me numër regjistrimi: 2315360000, aktiviteti ekonomik i kompanisë, shitja me shumicë dhe pakicë, të tekstileve dhe këpucëve.

II. Parashtruesi i njoftimit për Përqendrim obligohet të paguaj taksë administrative prej 100.00 € (njëqind euro) dhe për Vendimin për lejimin e Përqendrimit në vlerë prej 3,000.00 € (tre mijë euro).

Arsyetim

Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës më datë 22.08.2022, ka pranuar kërkesën me nr. prot. 222/22-01/H, përmes z.Fisnik Salihu, përfaqësues ligjor për ndërmarrjet lidhur me njoftimin për Përqendrim të ndërmarrjeve Alfi, Management of Alternative Investment Funds, Ltd (blerës) për blerje të 100% të aksioneve nga z. Bahtijar Bajrović së bashku me ndërmarrjen Sibelius Sonic Limited (shitësit).

Kërkesa për njoftim të përqendrimit është bërë për arsye se palët janë prezent me shitje në Republikën e Kosovës dhe për këtë arsye Autoriteti, si treg relevant ka përcaktuar tregun e Republikës së Kosovës.

Procedurat e ndjekura:

1. Vlerësimi i Lëndës/dokumentacionit
2. Vërtetimi për kërkesën e dorëzuar më datë 19.09.2022.
3. Njoftimi për realizimin e përqendrimit në web faqen e AKK-së më datë 09.09.2022

Kërkesa për Përqendrim është bazuar në marrëveshjen e paleve për shitblerjen të aksioneve, të datës 14.03.2022, ku palët kanë nënshkruar Marrëveshjen për shitblerjen të aksioneve me të cilin ndërmarrja Alfi Management of Alternative Investment Funds Ltd, do të blejë nga z. Bahtijar Bajrovic dhe Sibelius Sonic Limited 100% të aksioneve në Sportina. Andaj, në bazë të kërkesës Sekretariati i Autoritetit ka bërë vlerësimin e Kërkesës për Përqendrim.

Baza Ligjore dhe Akti i Përqendrimit

- a) Qarkullimi i palëve në tregun ndërkombëtarë e kalon shumën 20,000,000.00 euro.
- b) Qarkullimi në tregun e brendshëm, kalon shumën 1,000,000.00 euro.
- c) Kontrata e shitblerjes ndërmjet palëve, datë 14.03.2022 ndërmjet Alfi Management of Alternative Investment Funds, Ltd” për blerjen të 100% të aksioneve nga z. Bahtijar Bajrovic dhe Sibelius Sonic Limited mbi kompaninë Sportina.

Vlerësimi i Konkurrencës

Tregu Relevant:

Tregu i produktit - aktiviteti ekonomik i kompanisë, shitja me shumicë dhe pakicë të tekstileve dhe këpucëve.

Tregu gjeografik - do të përcaktohet, territori i Republikës së Kosovës.

Tregjet e prekura: Transaksioni në fjalë do të rezultojë në një bashkim horizontal të vogël të aktiviteteve të Alfi dhe Sportina përbrenda grupit, vetëm tek një segment i vogël i tregut (veshje për fëmijë), e cila mund të konsiderohet e papërfillshme duke marrë për bazë përqindjen e shitjeve të tyre në tregun e Kosovë, transaksioni nuk do të shkaktojë ndonjë rritje të pjesës së tregut pra do ta ruajë pozicionin aktual në tregun relevant, në Republikën e Kosovës..

Efektet e konkurrencës në tregun përkatës, nga transaksioni i realizuar

Transaksioni i propozuar, do të realizohet në tregun gjeografik të Republikës së Sllovenisë, kërkesa për njoftim të përqendrimit është bërë për arsye se palët janë prezent me shitje në Republikën e Kosovës dhe për këtë arsye Autoriteti, si treg relevant ka përcaktuar tregun e Republikës së Kosovës. Sipas vlerësimit të përqendrimit, nga ky transaksion, nuk parashihet se do të ketë efekte negative për konkurrencën, e rrjedhimisht për konsumatorët në Republikën e Kosovës. Nga vlerësimi i të dhënave të ofruara konsiderojmë se nga implementimi i këtij transaksioni nuk vërehet se do të ketë, kufizim ose shtrembërim të konkurrencës në treg.

Shënim;

Çdo formë e shtrembërimit të konkurrencës, respektivisht sjellje anti konkurruese do të jetë nën monitorimin e Autoritetit Kosovar të Konkurrencës.

III. Ky vendim, hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Komisioni.

Me këtë Vendim të njoftohen:

- Palët
- Arkiva

Kaltrina Sela
Zv. Kryetare



Nëime Binaku-Isufi
Kryetare



Nafije Osdautaj
Anëtare



Besim Stublla
Anëtar